Mekanizmi Koordinues Vendor i Shqipërisë (MKV)
Manuali dhe Plani i Mbikëqyrjes

Miratuar në Mbledhjen e MKV-s mbajtur më 23 dhjetor 2014

Përmbajtja

Hyrje ..... **Error! Bookmark not defined.**
Përkufizimi dhe Arsyetime ..... **Error! Bookmark not defined.**
Parimet e Mbikëqyrjes së MKV-s ..... **Error! Bookmark not defined.**
Standardet për Mbikëqyrjen ..... **Error! Bookmark not defined.**
Komiteti për Mbikëqyrje i MKV-s ..... **Error! Bookmark not defined.**
Përgjegjësitë e përgjithshme ..... **Error! Bookmark not defined.**
Manuali i Qeverisjes dhe Përgjegjësitë e MKV-s ..... **Error! Bookmark not defined.**
Anëtarësia e Komitetit Mbikëqyrës ..... **Error! Bookmark not defined.**
Kërkesa të përgjithshme ..... **Error! Bookmark not defined.**
Kërkesa të veçanta ..... **Error! Bookmark not defined.**
Ekspertiza dhe përvoja e Anëtarësisë ..... **Error! Bookmark not defined.**
Rregullorja e punës 5
Aktivitetet e mbikëqyrjes ..... **Error! Bookmark not defined.**
Plani i punës dhe Buxheti ..... **Error! Bookmark not defined.**
Përgjegjësitë e Sekretariatit të MKV-s për mbikëqyrjen e Grantit ..... **Error! Bookmark not defined.**
Vizitat Mbikëqyrëse ..... **Error! Bookmark not defined.**
Angazhimi i njerëzve që jetojnë me/ ose të prekur nga sëmundjet **Error! Bookmark not defined.**
Planet e Komunikimit për Mbikëqyrjen e Grantit ..... **Error! Bookmark not defined.**
Riprogramimi i Grantit ..... **Error! Bookmark not defined.**
Ndjekja e Çështjeve Urgjente të Performancës së Grantit ..... **Error! Bookmark not defined.**
Asistenca Teknike për Grantet ..... **Error! Bookmark not defined.**
Shtojca 1: Termat e Referencës për Komitetin Mbikëqyrës ..... **Error! Bookmark not defined.**
1. Qëllimi ..... **Error! Bookmark not defined.**
2. Anëtarësia ..... **Error! Bookmark not defined.**
3. Frekuencat e Takimeve ..... **Error! Bookmark not defined.**
4. Rolet dhe Përgjegjësitë e Komitetit Mbikëqyrës ..... **Error! Bookmark not defined.**
5. Grupet Teknike të Punës ..... **Error! Bookmark not defined.**
Shtojca 2: Aktivitetet e mbikëqyrjes ..... **Error! Bookmark not defined.**
Shtojca 3: Plani i Punës i Mbikëqyrjes ..... **Error! Bookmark not defined.**
Shtojca 4: Përgjegjësitë e mbikëqyrjes së Grantit për Sekretariatin e MKV-s **Error! Bookmark not defined.**
Shtojca 5: Udhëzime për vizitat mbikqyrëse të MKV-s ..... **Error! Bookmark not defined.**
Shtojca 6: Plani i Zhvillimit të Komunikimit për Mbikqyrjen e Grantit **Error! Bookmark not defined.**

Hyrje

Ky Plan është përgatitur nga MKV-ja e Shqipërisë nëpërmjet Komitetit të saj Mbikëqyrës për të siguruar një udhëzues dhe një kuadër për mbikëqyrjen e zbatimit të granteve të Fondit Global nga Përfituesi/it Kryesorë dhe nga Nën Kontraktuesit.

Përkufizimi dhe Arsyetime

Mbikëqyrja është një funksion kyç i MKV-s. Prandaj mbikëqyrja kërkon kryerjen e një sërë aktivitetesh të koordinuara për të mbështetur dhe për të siguruar që aktivitetet e grantit janë zbatuar ashtu siç janë planifikuar, dhe janë identifikuar dhe zgjidhur çështjet e pengesat në zbatimin e granteve.

Mbikëqyrja duhet të rezultojë në ofrimin e drejtimin strategjik nga MKV-ja për Përfituesin/it Kryesorë , si edhe si një vazhdim logjik për të siguruar bindjen që agjencitë zbatuese të veprojnë bazuar në rekomandimet e mbikëqyrjes dhe veprimeve korrigjuese të kërkuara.

Mbikëqyrja nga MKV-ja vjen si një kërkesë minimale e drejtë (Kërkesa 3 sipas Udhëzime dhe Kërkesa për MKV-n) për pranimin e financimit nga Fondi Global. Në mënyrë të veçantë, Fondi Global kërkon që MKV-ja duhet "të paraqesë dhe të ndjek një plan të mbikëqyrjes për të gjitha financimet e miratuara nga Fondi Global. Aktivitetet e plait të mbikëqyrjes duhet të detajohen me hollësi, dhe duhet të përshkruajnë mënyrën se si MKV-ja do të angazhohet, aktorët e programit të mbikëqyrjes, duke përfshirë anëtarë dhe jo-anëtarë të MKV-s, dhe në veçanti grupimet jo-qeveritare dhe njerëzit që jetojnë me dhe / ose të prekur nga sëmundjet".

Parimet e mbikëqyrjes së MKV-s

Fondi Global ika përcaktuar disa parime themelore në lidhje me kërkesat për kryerjen e mbikëqyrjes nga MKV-ja:
1. "MKV mbikëqyrë performancën e PK për të siguruar se ai/ata do të arrijnë objektivat e miratuara të programeve që janë në zbatim.
2. Roli mbikëqyrës i MKV-s është i rëndësishëm për të zbutur rrezikut dhe arritur kapërcimin e pengesave.
3. Nëpërmjet mbikëqyrjes së MKV-s, PK mban përgjegjësi për të gjitha grupet e interesit të vendit. "[1]

Korniza për këtë Plan Mbikëqyrës është e bazuar në parimet themelore të mësipërme dhe udhëzimet lidhur me të tregohet më poshtë:
Mbikëqyrja është një përgjegjësi kombëtare.
Siç thuhet në Dokumentin Udhëzues të Fondit Global për Mbikëqyrjen e MKV-s ", parimi bazë i mbikëqyrjes është të sigurojë që burimet - financiare dhe njerëzore - janë duke u përdorur në mënyrë efikase dhe efektive për të mirën e vendit". MKV-ja Shqipëria është përgjegjëse për koordinimin e përgjithshëm të granteve të Fondit Global brenda vendit.

Mbikëqyrja ndryshon nga monitorimi dhe vlerësimi.
Aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit duhet të përqëndrohen në aktivitetet e detajuara të zbatimit të programit, të cilat janë përgjegjësi e Përfituesit Kryesor dhe Agjencive të tjera zbatuese.

[1] *Shënim Udhëzues: Kërkesat e MKV-s,* Fondi Global, Qershor 2011

Në të kundërt, fokusi i mbikëqyrjes është një "panoramë e madhe" e zbatimit të grantit. Ajo heton të gjithë grantet për të identifikuar çështjet ndërsektoriale, dhe theksi vihet në identifikimin dhe zgjidhjen e çështjeve të rrezikshme për suksesin e granteve.

Mbikëqyrja fokusohet në disa fusha kyçe. Mbikëqyrja zakonisht fokusohet në disa pyetje kyçe që janë në thelb të zbatimit efektiv të grantit:

- Ku janë parat?
- Ku janë ilaçet, furnizimet mjekësore dhe pajisjet?
- A po marrin Nën-Kontraktuesit burimet e kërkuara dhe asistencë teknike siç është planifikuar?
- A janë duke u zbatuar grantet sikurse janë planifikuar?
- Cilat janë pengesat për zbatimin e grantit dhe se si mund të zgjidhen ato?
- A është i nevojshëm riprogramimi i aktiviteteve për të plotësuar nevojat e zhvillimit në vendit?
- A janë rezultatet në përputhje me objektivat e performancës?

Mbikëqyrja është me periudha. Mbikëqyrja vijon raportimin me cikle për të shqyrtuar punën e Përfituesit/ve Kryesorë, menaxherët e programit, ekzekutimin në kohë të planeve të punës dhe rezultateve teknike krahasuar me objektivat gjashtë-mujore dhe vjetore.

Autoriteti i MKV-s Shqipëri për të mbikëqyrur zbatimin e Fondit Global nga Përfituesit/ve Kryesorë: Parimet bazë mbi të përcaktojnë se Fondi Global i kërkon MKV-s së Shqipërisë duhet të mbajë nën përgjegjësi/llogaridhënie Përfituesit/ve Kryesorë për burimet e dhëna për vendin: "MKV-ja mbikëqyrë performancën e PK për të siguruar që ata do të arrijnë objektivat e programeve të rëna dakord dhe janë në zbatim. Nëpërmjet MKV mbikëqyret PK që mban përgjegjësi për të gjitha palët e interesit të vendit. "

Në mënyrë të ngjashme, Neni 7 (b) i marrëveshjes së Fondit Global me çdo Përfituesit Kryesor kërkon që "Përfituesi Kryesor të bashkëpunojë me MKV-n dhe Fondin Global për të përmbushur qëllimin e kësaj Marrëveshjeje .... Me kërkesën e MKV-s për qëllime informimi Përfituesi Kryesor do t'i sigurojë MKV-s, një kopje të raporteve dhe materialeve informuese lidhur me Programin . "[2]

Standardet e Mbikëqyrjes

Bazuar në përvojën e fituar Fondi Global ka identifikuar një numër të "standardeve që paraqesin kritere të rëndësishme që konsiderohen jetike për kryerjen efektive dhe performancën e MKV-s." [3] Këto standarde nuk janë kushte për financimin e Fondit Global, por ato janë përdorur nga ana e Fondit Global, si pjesë e vlerësimit të performanca e përgjithshme të MKV-s. Dy standardet përkatëse të mbikëqyrjes janë si më poshtë:

i. "MKV-ja duhet të sigurojnë që programi i aktiviteteve të kontribuojë në eliminimin e stigmatizimit dhe të diskriminimit ndaj atyre që jetojnë me të dhe të prekur nga këto sëmundje, veçanërisht popullata që janë të margjinalizuar ose të kriminalizuar.

ii. Çdo MKV duhet të ketë një strategji të komunikimit të dakordsuar me PK të saj, duke detajuar aktivitetee e komunikimit gjatë gjithë ciklit jetësor të granteve, dhe duke përfshirë përditësime të planifikuara financiare dhe programore për MKV për performancën e PK dhe NK. "[4]

Komiteti Mbikëqyrës i MKV-s Shqipëri

---

[2]Fondi Global dhe Marrwveshja me Pwrfituesin Kryesor , Neni 7 (b).

[3]*Udhwzime dheKwrkesa pwr MKV-n*. Fondi Global, Maj 2011

[4]Ibid, Clause 33.

Mbikëqyrja është përgjegjësi kryesor e MKV-s. Si rrrjedhojë, të gjithë anëtarët MKV-s kanë përgjegjësi për të marrë pjesë në mbështetjen e aktiviteteve të mbikëqyrjes. Megjithatë, për të lehtësuar punën efektive të këtij roli, MKV-ja ka themeluar një Komitet Mbikëqyrës "për të diskutuar dhe për të bërë rekomandime për të gjitha çështjet e mbikëqyrjes në përputhje me Termat e (saj) të Referencës dhe planin e vet të punës, apo për çdo çështje që i referohen atij nga MKV-ja e Shqipërisë. "[5]

Përgjegjësitë e përgjithshme. Komiteti Mbikëqyrës i MKV-s është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen për grantet ekzistuese të Fondit Global në Shqipëri në tri fusha:
Financiar – për të siguruar përdorimin e duhur, në kohë dhe efektiv të fondeve nga Fondi Global;
Programatik – për të siguruar zbatimin në kohë dhe efektiv të planeve të punës të PK dhe NK;
Performance – për të siguruar arritjen e rezultateve të synuara në periudha afatshkurtra të ndërmjetme dhe afatgjata.
Këto përgjegjësi kanë të bëjnë me të gjitha fushat e zbatimit të grantit:
• Në të gjitha fazat / hapat e zbatimit;
• Ndryshime të mëdha në grante, duke përfshirë ndryshimet në objektivat e punës, strukturën e treguesve të performancës së grantit, riprogramimin dhe ndryshimet në përcaktimin e partnerëve të zbatimit;
• Mbylljen e Grantit, duke përfshirë rishikimin dhe miratimin e ndonjë plani të mbylljes/çlirimit(p.sh., shpërndarjen dhe asgjësimin e aseteve të programit) dhe buxheteve.

Manuali Përgjegjësive të Qeverisjes së MKV-s. Manuali i Qeverisjes së MKV-s Shqipëri përfshin Termat e Referencës së Komitetit Mbikëqyës, të përsëritura në Aneksin 1 të këtij Plani, dhe të përshkruara si më poshtë:

i. Komiteti Mbikëqyrës është i autorizuar të diskutoj dhe të bëj rekomandime për të gjitha çështjet e mbikëqyrjes në përputhje me këto Terma Referimi dhe të planit të saj të punës, apo për çdo çështje që i referohet atij nga MKV-ja e Shqipërisë.
ii. Pas hartimit të rekomandimeve Komiteti Mbikëqyrës duhet të paraqesë të gjitha rekomandimet në mbledhjen e ardhshme të MKV-s Shqipërisë.
iii. Në konsultim me MKV-n e Shqipërisë, Komisioni për Mbikëqyrjen duhet të udhëheq ose të kontribuojnë në proceset e mëposhtme të mbikëqyrjes:
a. Zbatimin e Grantit;
b. Rishikimet periodike
c. Vlerësimin e mbylljes së Grantit;
d. Koordinimin e donatorëve dhe delegimin me sistemet shëndetësore;
e. Mbylljen e Grantit.
Komiteti Mbikëqyrës duhet të sigurojë kryerjen e funksioneve të tij mbikëqyrëse në lidhje me fushat e mëposhtme të programeve të financimit dhe aktiviteteve të Fondit Global në Shqipëri:
a. Financave, përfshirë përjashtimit nga taksat,
b. Menaxhimit të Grant nga ana e PK;
c. Prokurimit;
d. Zbatimit;
e. Partneritetit PK / NK;
f. Rezultateve;
g. Raportimit;

[5]*Manuali I MKV-s Shqipwri*, Shtojca 2 Termat e Referencws tw Kmitetit Mbikqyrws

h. Asistencës teknike. [6]

Anëtarësia e Komitetit Mbikëqyrës

Kërkesa të përgjithshme. Kërkesa të përgjithshme për anëtarësinë e Komitetit Mbikëqyrës të MKV-s, si për të gjitha Komitetet e tjera të Përhershme, janë të përshkruara në Manualin e Qeverisjes së MKV-s dhe procedurat e veta operacionale:

• MKV-ja e Shqipërisë emëron anëtarët e Komitetit Mbikëqës.
• MKV-ja e Shqipërisë zgjedhë një Kryetar Komitetit Mbikëqyrës dhe një Zëvendës-Kryetar nga mesi anëtarësisë së tanishme të MKV-s. (Anëtarësimi MKV përfshinë anëtarë dhe zëvendësit).
• Përveç Kryetarit dhe Zëvendës-Kryetarit, Komiteti Mbikëqyrës do të ketë pesë Anëtarë të zakonshëm, të cilët nuk duhet të jenë anëtarë të MKV-s.
• Komiteti Mbikëqyrës duhet të ketë një anëtarë me ekspertizë në Menaxhimin e Financave, Prokurimit dhe menaxhimit të furnizimit.
• Përveç ekspertizës së mësipërme nga një përfaqësues prej njerëzve që jetojnë me këtë sëmundje (PLMS) dhe popullatave kyçe të prekura (PK) do të jetë pjesë e Komitetit Mbikëqyrës.

Kërkesa të veçanta. Kërkesa të tjera unike anëtarësimi, të Komitetit Mbikëqyrës MKV përfshijnë:
• Përfituesi/t Kryesore, Nën-Kontraktorët dhe Nën-Nën-Kontraktorët e kanë të ndaluar të shërbejnë në Komitet. [7] Siç specifikohet në Manualin e Qeverisjes së MKV-s, Anëtarët e Komitetit "nuk duhet të jenë përfaqësues të Përfituesi/t Kryesorë as të Nën-Kontraktorëve dhe Nën-Nën-Kontraktorëve " Kjo kërkesë reflekton nevojën për të shmangur konfliktin e interesit e natyrshme në çdo individ që ka rol zbatues dhe mbikëqyrës për programet e Fondit Global.
• Më tej, kandidatët për anëtarë të Komitetit Mbikëqyrës të cilët nuk janë anëtarë të MKV-s "duhet të plotësojnë të njëjtën deklaratë të përgatitur të konfliktit të interesit si për të gjithë anëtarët e MKV-s. MKV-ja do të përcaktojë nëse, në bazë të deklaratës së kandidatit jo anëtarë të MKV-së, ai / ajo i plotëson standardet për konfliktin e interesit të kërkuara për anëtarë të Komitetit Mbikëqyrës. ."[8]

Ekspertiza dhe përvoja e Anëtarësisë.
Komiteti Mbikëqyrës për përmbushjen e rolit të tij, në mënyrë që të ketë një grup të aftë e gjithëpërfshirës, duhet të përpiqet që të ketë anëtarë me ekspertizë në fushat e mëposhtme:
• Zbatimit të ndërhyrjeve publike dhe sektorit privat të programeve e HIV-AIDS, TB apo Forcimin e Sistemit Shëndetësor (FSS) në nivele kombëtar dhe / ose lokale.
• Finance ose kontabilitet në organizatat e mëdha / të mesme publike apo në sektorin privat.
• Përvojë pune me organizatat avokuese që përfaqësojnë njerëzit që jetojnë me, ose të prekur nga sëmundjet.
• Anëtarët duhet të kenë përvojë të konsiderueshme (p.sh., 8-10 vjet) në fushat përkatëse të ekspertizës.

---

[6] Manuali i Qeverisjes sw MKV-s Shqipwri, Shtojca 2 Termat e Referencës së Komitetit Mbikëqyrws

[7] Pasi organizata, e cila përfaqësohet nga një anëtar nw Komitetit, aplikon të jetë një PK apo NK, anëtari menjëherë duhet të japë dorëheqjen nga funksioni i tij. Përgjegjësia për deklarimin e pwrfitimit të organizatës nga fondet e FG qëndron mbi anëtarin. Mosdeklarimi i anëtari përfaqësues pwr financimin e organizatws nga FG në kohën e duhur do të bëjë papërshtatshëm aplikimin për financim nga FG (përfshirë financimin e NK). Kjo duhet të bëhet brenda tremujorit të parë të vitit.

[8] Manuali i Qeverisjes sw MKV-s Shqipwri, Shtojca 2 Termat e Referencës së Komitetit Mbikëqyrws, Pika 2

Rregullorja e punës:

Komiteti Mbikëqyrës duhet të veprojë sipas rregullave të mëposhtme të procedurës:

1. Komiteti do të veprojë me shumicë të thjeshtë votash.
2. Kuorumi për mbledhjet do të jetë pesëdhjetë për qind të anëtarëve të saj.
3. Komiteti mblidhet të paktën çdo tre muaj dhe shpeshtësia e takimeve përcaktohet nga ana e anëtarëve të Komitetit në përputhje me përgjegjësitë e tij mbikëqyrëse (p.sh., ciklet e raportimit PK axhendës së mbledhjeve të MKV, dhe çështje apo nevojave të tjera relevante të mbikëqyrjes).
4. Koha e takimeve do të përcaktohet nga Kryetari i Komitetit Mbikëqyrës në konsultim me anëtarët e tjerë të Komitetit. Takimet do të zhvillohen të paktën 2 javë para çdo mbledhje të rregullt tremujore të MKV-s, në mënyrë që diskutimet e komitetit të mund të raportohet në MKV.
5. Çdo takim do të ketë një axhendë, e cila do të shpërndahet para Mbledhjes.
6. Kryetari do të drejtojë të gjitha mbledhjet e Komitetit Mbikëqyrës. Në rast se Kryetari nuk është në gjendje të marrë pjesë në një takim, do të drejtohet nga Zëvendës-Kryetari. Nëse të dy Kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesi mungojnë, dhe duke supozuar se kuorumi është i pranishëm, pjesëmarrësit e takimit do të caktojnë një Kryetar të përkohshëm. Kryetari i përkohshëm duhet të jetë një anëtar i MKV apo alternativë.
7. Në çdo mbledhje të komitetit, me mbështetjen e Sekretariatit Kryetari i Komitetit Mbikëqyrës, do të jetë përgjegjës për hartimin e një axhende
8. Kryetari i Komitetit Mbikëqyrës, me mbështetjen e Sekretariatit, do të jetë përgjegjës për të siguruar që rendi i ditës dhe çdo dokumentet ose informacionet e tjera që kanë të bëjnë me pikat e rendit të ditës u shpërndahen anëtarëve të komisionit jo më pak se dy javë para datës së caktuar të mbledhjes.
9. Procesverbali, duke përfshirë listën e të pranishmëve, do të përgatiten për çdo mbledhje dhe arkivohen nga Sekretariati. Procesverbalet e të gjitha takimeve të Komitetit Mbikëqyrës do të shtrohet në takimet e MKV-s.
10. Raportin me diskutimet dhe rekomandimet e tij, Komiteti Mbikëqyrës do ta paraqesë në Mbledhjen e radhës së MKV-s.
11. Sekretariati i MKV-s do ti ofrojë asistencën e nevojshme Komitetit Mbikëqyrës të tilla si mbajtja e minutave, mbështetja logjistike për aktivitetet mbikëqyrëse dhe çështje të tjera administrative.
12. Komiteti Mbikëqyrës për të pasuruar rrahjet e mendimeve mund të ftojë për të marrë pjesë në mbledhjet e tij, përfaqësues të KP dhe NK dhe partnerë të tjerë implementues e palët e interesuara, në funksion të dhënies së informacionit, komenteve, dhe ekspertizës.